



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 242, datë 29.12.2021

MBI
MIRATIMIN E PËRSHTATSHMËRISË DHE ZGJERIMIT TË LICENCËS SË
SHOQËRISË “BANKA OTP ALBANIA” SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572 datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 21, nenit 377, të Ligjit nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit” dhe Rregullores nr. 195, datë 29.12.2020 “Për licencimin e shoqërisë komisionere, regjistrimin e degës së shoqërisë së huaj komisionere dhe njohjen e shoqërisë së huaj komisionere”, e ndryshuar, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

Shoqëria “Banka OTP Albania” sh.a., disponon licencën nr. 5, datë 25.06.2009 “Për ushtrimin e veprimtarisë si shoqëri brokerimi në Letra me Vlerë të Qeverisë të Republikës së Shqipërisë në Bursë” dhe licencën nr. 5/1 datë 21.03.2012 “Për ushtrimin e veprimtarisë si shoqëri brokerimi në Letra me Vlerë të Qeverisë në tregun me pakicë”, sipas Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për titujt”, i shfuqizuar. Licenca si shoqëri brokerimi nga pikëpamja e veprimtarive të lejuara është e njëjtë me shërbimet e investimit si: Marrje dhe transmetim urdhërash të klientit, ekzekutim urdhërash, të përcaktuara në Ligjin nr. 62/2020.

Shoqëria “Banka OTP Albania” sh.a., mban gjithashtu licencën nr. 8, datë 13.12.2011 “Për shërbimet e kujdestarisë së Letrave me Vlerë të Qeverisë së RSH”. Sipas Ligjit nr. 62/2020, shërbimi i kujdestarisë apo ruajtja dhe administrimi i instrumenteve financiare në emër të klientëve, konsiderohet shërbim ndihmës.

“Banka OTP Albania” sh.a., ka paraqitur raportin e përshtatshmërisë së veprimtarisë me kërkesat e Ligjit nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit” dhe Rregullores nr. 195, datë 29.12.2020 “Për licencimin e shoqërisë komisionere, regjistrimin e degës së shoqërisë së huaj komisionere dhe njohjen e shoqërisë së huaj komisionere”, e ndryshuar, si dhe ka depozituar kërkesën për zgjerimin e licencës me qëllim zgjerimin e gamës së instrumenteve financiare që do t’i ofrojë klientëve. Më konkretisht, shërbimet e investimit dhe instrumentet financiare që do ofrohen nga “Banka OTP Albania” sh.a., janë:

1. Marrja dhe transmetimi i urdhrave në lidhje me një ose më shumë instrumente financiare;
2. Ekzekutimi i urdhrave në emër të klientëve.

Shërbimet ndihmëse:

- Ruajtja dhe administrimi i instrumenteve financiare në emër të klientëve.

Instrumentet financiare:

1. Titujt e transferueshëm;
2. Instrumentet e tregut të parasë;
3. Kuotat e sipërmarrjeve të investimeve kolektive.

Për sa më sipër, Bordi i Autoriteit të Mbikëqyrjes Financiare:

V E N D O S I:

1. **Miratimin e përshtatshmërisë së shoqërisë “Banka OTP Albania” sh.a., me kërkesat e Ligjit nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit” dhe rregulloreve në zbatim të tij, për:**

A. Ofrimin e shërbimeve të investimit në Tituj e Qeverisë si:

- a) Marrje dhe transmetim i urdhrave;
- b) Ekzekutim i urdhrave në emër të klientëve.

B. Ofrimin e shërbimit ndihmës në tituj e Qeverisë si:

- Ruajtja dhe administrimi i instrumenteve financiare në emër të klientëve.

2. **Miratimin e zgjerimit të licencës së shoqërisë “Banka OTP Albania” sh.a., për:**

A. Instrumentet financiare si më poshtë:

1. Titujt e transferueshëm;
2. Instrumentet e tregut të parasë;
3. Kuotat e sipërmarrjeve të investimeve kolektive.

Duke përjashtuar titujt e transferueshëm dhe instrumentet e tregut të parasë, të cilat përmbajnë në strukturën e tyre një instrument derivative, apo që konsiderohen instrumente komplekse.

B. Ofrimin e shërbimit ndihmës “Ruajtja dhe administrimi i instrumenteve financiare në emër të klientëve”, për të gjitha instrumentet financiare të listuar më sipër.

3. **Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, si dhe Drejtorja e Licencimit për njoftimet dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Olsi ÇOKU

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin METE